



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/ Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

---

KONFERENCA IV SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

**NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË**  
**INTEGRITETIN E SEKTORIT TË RENDIT DHE**  
**SIGURISË PUBLIKE**

16 - 18 nëntor, 2022  
Prishtinë, Kosovë

## **THIRRJE PËR PJESËMARRJE**

Nga 16 - 18 nëntor 2022, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) organizon Konferencën e katërt shkencore ndërkombëtare me titull "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në integritetin e rendit dhe sigurisë publike".

Konferenca do të përqëndrohet në efektet negative, zbutjen dhe reagimet për fazat e rimëkëmbjes të sektorit të rendit dhe sigurisë për ndikimet e COVID-19 në siguri. Konferenca mbështetet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe do të mbahet në Prishtinë, Kosovë.

Ftohen akademikë, studentë, hulumtues shkencorë dhe profesionistë të tjerë të pavarur ose të punësuar në fushat e rendit dhe sigurisë publike, institucionet shtetërore, institucionet e arsimit ose hulumtimit nga Kosova, Ballkani Perëndimor, Evropa dhe më gjerë, për të prezentuar pikëvështrimet e tyre përmes punimeve shkencore se si pandemia COVID-19 ka ndikuar në integritetin e zbatimit të ligjit në shtetet dhe/ose shoqëritë e tyre përkatëse.

Gjatë Konferencës, nga pjesëmarrësit do të kërkohet që t'i prezantojnë hulumtimet ose dokumentet e tyre në gjuhën angleze, shqipe ose serbe, pasi që përkthimi simultan profesional do të ofrohet në të gjitha tri gjuhët e lartpërmendura.

### **Objektivi i Konferencës**

Sfidat globale, siç janë pandemitë dhe fatkeqësitë e ndryshme natyrore dhe efektet e tyre me ndikim në integritetin e agjencive të sigurisë publike, i detyrojnë shoqëritë të rrisin investimet në parandalim dhe të përforcojnë përpjekjet për arsim dhe trajnim proaktiv për zyrtarët e sigurisë publike.

Ngjashëm me incidentet kritike që ndodhin natyrshëm dhe që shkaktojnë dëme në shoqëri, si uraganet, përmytjet ose tërmetet, por edhe ato që kanë të bëjnë me kërcënimet moderne të sigurisë, siç është terrorizmi, edhe pandemia COVID-19 ka paraqitur pengesa në zbatimin e ligjit. Ndikimet e tilla përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në komunikim, menaxhim të burimeve njerëzore, zbatim të kufizimeve të shëndetit publik dhe rritje të krimit dhe/ose modaliteteve të reja kriminale. Bazuar në këto sfida globale, parandalimin e tyre, fazat e rimëkëmbjes si dhe nevojën për të shkëmbyer ekspertizën për t'u përballur me këto sfida kërcënuese për njerëzimin në fazat fillestare, Konferenca synon të nxjerrë në pah masat për reagimet ndaj pandemisë dhe situatave të ngjashme të jashtëzakonshme, në mënyrë që të garantojë në radhë të parë rendin dhe sigurinë si dhe mirëqenien e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe komuniteteve të cilave ata u shërbejnë.

Në këtë kontekst, puna hulumtuese që do të prezantohet në Konferencë, përfshirë rekomandimet që mund të dalin, do t'i shërbejnë AKSP-së dhe Institutit të saj për Hulumtim dhe Zhvillim integrimin e rekomandimeve në programin e saj studimor në

fushën e sigurisë publike. Për më tepër, puna hulumtuese do t'i ndihmojë AKSP-së që të krijojë edhe programe të reja studimi për parandalim dhe menaxhim më të mirë të sektorit të rendit dhe sigurisë publike. Kjo do të mundësojë rritjen e kompetencës së atyre zyrtarëve që ofrojnë drejtpërdrejt iniciatva në siguri publike si dhe të përmirësojë kujdesin ndaj kërcënimeve ekzistuese të shkaktuara nga shpërthimet pandemike. Përkushtimi i AKSP-së duke u fokusuar në parandalim dhe rimëkëmbje të çështjeve më urgjente për menaxherët dhe drejtuesit e agjencive të sigurisë publike dhe institucioneve relevante gjatë fatkeqësive natyrore dhe pandemieve do të rrisë edhe më tepër integritetin e ofruesve të zbatimit të ligjit.

### **Qëllimi i Konferencës**

Konferenca synon të mbledhë së bashku studiues në fushën e rendit dhe sigurisë publike nga Kosova, Ballkani Perëndimor, Evropa dhe gjetiu, me qëllim të shkëmbimit të përvojave vendore dhe ndërkombëtare dhe prezantimit të modeleve të zbutjes së efekteve të pandemieve si dhe hapat e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19. Modelet e tilla dhe përgjigja të ndërrmarra nga institucionet tyre përkatëse, përvojat konkrete të tyre dhe gjetjet shkencore nga hulumtimi, do të ngrisin qasjet praktike të pjesëmarrësve për të parandaluar kërcënimet e përbashkëta transnacionale, si ato të ndodhura gjatë pandemisë COVID-19.

Kosova, më shumë se të tjerët, ka nevojë për të mësuar nga përvojat dhe rezultatet e arritura gjetiu dhe të aplikojë praktikatat e tilla më të mira përmes adresimit të pandemisë COVID-19 dhe sfidave që kanë të bëjnë me integritetin e agjencive të zbatimit të ligjit dhe situatave të jashtëzakonshme.

### **Struktura e Konferencës**

Konferenca do të organizohet në sesione plenare në Prishtinë fizikisht dhe me platforma hibride. AKSP po kërkon përafërsisht 28 - 30 profesionistë që të prezantojnë njëherën nga temat që kanë të bëjë me ndikim e pandemisë, parandalimin apo masat e ndërrmarra për rimëkëmbje si në vijim:

- Etika dhe integriteti i zbatuesve të ligjit gjatë situatave emergjente ose pandemisë COVID-19
- Policimi në bashkësi dhe sfidat gjatë pandemisë COVID-19
- Shërbimi sprovues dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në integritetin e tij
- Shërbimi korrektues dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në integritetin e tij
- Dogana dhe ndikimi në i pandemisë COVID-19 në integritetin e saj
- Shërbimet e zjarrfikjes, shpëtimit dhe emergjencave dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në integritetin e tyre
- Ndikimi i pandemisë COVID-19 në avancimin e platformave teknologjike të trajnimit dhe arsimit në rend dhe siguri publike
- Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ritjen e e llojeve të krimit

- Ndikimi i pandemisë COVID-19 në rritjen e krimeve kibernetike, lajmeve të rrejshme (Fake Neës si dhe sigurinë kibernetike ne përgjithësi)
- Inteligjenca me Burim të Hapur (OSINT) në epokën e pandemisë COVID-19
- Shëndeti mendor dhe policimi gjatë kohës së krizave dhe pandemive
- Gratë në policim dhe ndikimi i pandemisë COVID-19
- Ndikimi i pandemisë COVID-19 në rritjen e rasteve të dhunës në familje dhe sfidat për mbrojtjen dhe intervistimin e viktimave
- Ndikimi i pandemisë COVID-19 në rritjen e rasteve të ngacmimit seksual dhe sfidat për mbrojtjen dhe intervistimin e viktimave
- Praktikat më të mira të zhvillimit të kurrikulës së trajnimit gjithëpërfshirës që përfshin skenarë realistë për menagjimin e situatave emergjente, fatkeqësive natyrore dhe pandemive.

Të gjitha abstraktet do të analizohen nga Bordi Shkencor i AKSP-së dhe çdo abstrakt i pranuar do të prezantohet në Konferencë. Prezentimi i punimeve hulumtuese shkencore do të bëhet në Poëer Point. Çdo prezentim është paraparë të zgjasë më së shumti 20 minuta dhe të lejojë edhe për më së shumti 5 minuta shtesë për pyetje dhe përgjigje nga audienca.

### **Datat e rëndësishme**

Dorëzimi i abstrakteve: deri më 10 tetor 2022

Njoftimi për pranimin e abstrakteve: nga 10 tetor 2022 deri më 15 tetor 2022

Dorëzimi i punimeve përfundimtare: nga 16 tetor 2022 deri më 25 tetor 2022

Njoftimi për pranimin e punimeve të plota: nga 26 tetor 2022 deri më 5 nëntor 2022

Datat e Konferencës: 16 - 18 nëntor 2022

### **Procesi i dorëzimit dhe shqyrtimit**

Bordi Shkencor i AKSP-së (Bordi) mbetet me autoritetin diskrecional që të përzgjedhë punimet të cilat do të prezantohen gjatë Konferencës. Nëse punimet pranohen nga Bordi, autor-i/ët do të njoftohet/n për pjesëmarrje në Konferencë. Dorëzimi i pranuar do të përfshijë njoftimin e autori-t/ëve me "Strukturën dhe standardet e punimit shkencor", në bazë të së cilës do të përgatiten dhe dorëzohen punimet.

Abstrakti duhet të përmbajë së paku 250 fjalë por më së shumti 300 fjalë, me 4 - 5 fjalë kyçe. Abstraktet mund të dorëzohen me e-mail ose USB/CD në AKSP në Vushtrri.

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Gjuhët zyrtare të Konferencës janë shqip, serbisht dhe anglisht. Abstrakti i punimeve i paraqitur në të gjitha të tri gjuhët;

- Duhet të përmbajë emrin e plotë të autorit/ autorëve, përkatësinë institucionale dhe e-mail adresën;
- Teksti të shkruhet dhe shtypet me hapësirën 1.15 ndërmjet rreshtave në fondin “Time Neë Roman” dhe madhësia e shkronjave duhet të jetë 12-të.

Punimet dhe prezantimet nuk duhet të kenë qenë të botuara apo prezantuara më parë gjetiu.

Pas dorëzimit të abstrakteve dhe vlerësimit, bazuar në orarin më sipër, autorët do të njoftohen për pjesëmarrjen e tyre në Konferencë, dhe detajet shtesë, siç janë agjenda, lokacioni dhe modalitetet e prezentimit.

Për çdo pyetje lidhur me Konferencën, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni përmes pikave të kontaktit si në vijim:

- Komisionin për organizimin e Konferencës [kaps.conference@rks-gov.net](mailto:kaps.conference@rks-gov.net),
- Dr. Ferid Azemin, Udhëheqës i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim, në [ferid.azemi@rks-gov.net](mailto:ferid.azemi@rks-gov.net) dhe
- Këshilltaren për AKSP në Misionin e OSBE-së në Kosovë, znj. Shpresa Muharremi, në e-mail [shpresa.muharremi@osce.org](mailto:shpresa.muharremi@osce.org).

Punimet e Konferencës do të botohen në një vëllim të pajisur me ISBN. Informacione të mëtejshme rreth Konferencës mund të gjenden në faqen zyrtare të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike <http://aksp-ks.net>, dhe specifikiisht te “KONFERENCA” në <http://aksp-ks.net/?page=1,265>

Do t’iu ishim mirënjohës nëse ju e ndani këtë thirrje për pjesëmarrje në Konferencë edhe me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj.

Ju falënderojmë për interesimin tuaj.

Kjo Konferencë është e përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.